



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 27.04.2020

- I. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.04.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " **SIB-BKA** " **SH.P.K**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: –“ **Hartimi i projekteve të ndërtimit të ulët, me Nr. të Prok: 632-20-1101-2-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

- II. 1. **APROVOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim Operatori Ekonomik " **SIB-BKA** " **SH.P.K** sh.p.k , e dt.23.04.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Hartimi i projekteve të ndërtimit të ulët, me Nr. të Prok: 632-20-1101-2-1-1**, Nr. Brendshëm **632-003-211**, kundër **Dosjes së tenderit**, te AK –së, të datës 31.03.2020, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. Vërtetohet **DOSJA E TENDERIT E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, e publikuar me datë: **31.03.2020**;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Ar sy e t i m

Meqë Operatori Ekonomik " **SIB-BKA** " **SH.P.K**, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit **Hartimi i projekteve të ndërtimit të ulët, me Nr. të Prok: 632-20-1101-2-1-1**, Nr. Brendshëm **632-003-211**,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 27.04.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi 1: Autoriteti Kontraktues, duke kerkuar qe i gjithe stafi - menagjeri perfshi dhe gjashte inxhinier te jene te paraqitur ne ATK (i punesuar prane ofertuesit minimum tre vitet e fundit!?) shkel ligjin e prokurimit ne nenin 1, 6 dhe 7, duke krijuar kushte per konkurrence jolojale, dhe duke ngushtuar aftesine konkurruese permes kushteve te cilat-nuk ndihmojne ne marrjen e sherbimeve kualitative. Nese inxhinieret kane qene te punesuar ne ndonje kompani tjeter dhe kane pervojen e mjaftueshme pse mos te kerkohet deshmia e te njetit-qofte edhe permes paraqitjes ne ATK ne kompanin ku ka ushtruar profesionin me heret, por jo detyrimisht i punesuar tre vitet e fundit te ofertuesi!? Sa i perket kerkeses: *nje bachelor te ndertimtarise drejtimi konstruksion apo infrastrukture rrugore - me pervoje pune profesionale minimumi 5 vile; nje inxhinier i diplomuar ose master ne inxhinieri to ndertimit dhe arkitektures drejtimi infrastrukture rrugore pervoje pune ne projektim te ndertimit te ulet se paku 1 vite pervoje pune. AK eshte ne kundershitim me vetveten, nuk mund te kerkohet i punesuar ne kompani tre vitet e fundit ndersa pervoja e kerkuar eshte 1 vite pune?*

AK, sa i perket kesaj kerkese eshte ne kundershitim me vetveten. Nuk mund te jete i paraqitur ne ATK ne tre vitet e fundit nje punetore profesional i cili e ploteson kriterin e kerkuar me me se paku 1 vite pervoje pune!

Njekohesisht, bazuar ne ligjet e aplikueshme ne Kosove, punesimi i eksperteve te jashtem eshte i lejuar, duke themeluar mardhenje pune me afat te caktuar. Autoriteti Kontraktues limiton shfrytezimin e mundesive reale dhe ligjore per plotesimin e keti kriteri. Pra, keto kerkesa te AK jane diskriminuese dhe tendencioze per pershtatje te OE te caktuar paraprakisht pa asnje dyshim!!!

Kerkojme nga AK, ne kuader te kesaj kerkese per rishqyrtim te kriterëve, te hiqet kushti qe i gjithe personeli te jene te paraqitur ne ATK e sidomos tre vitet e fundit vetem te ofertuesi, Te shtohet — per stafin qe nuk eshte i punesuar tek ofertuesi mund te paraqitet marreveshje punesimi mes paleve (me garanci te tjera shtese nese eshte e nevojshme), duke permendur emrin dhe numrin e procedures se prokuri m it.

Përgjigje1 1: Ne si AK, jemi duke kërkuar të lidhim kontratë me operatorë apo grup të operatorëve të cilët përveç tjerash, ofrojnë staf të kualifikuar dhe me përvojë profesionale, një ndër dëshmitë e cila tregon se OE apo Grupi i OE ka staf profesional dhe me përvojë profesionale në projektim të ndërtimi të ulët është lista e ATK-ës për tre vitet e fundit. Ndërsa ju njoftojmë se sa i përket kërkesës për - një inxhinier i diplomuar ose master në inxhinieri të ndërtimit dhe arkitekturës drejtimi infrastrukturë rrugore - me përvojë pune në projektim të ndërtimit të ulët së paku 1 vite përvojë pune, është kërkuar përvoja 1 vjeçare për arsye se dega infrastrukturë rrugore e nivelit master është e re prandaj nuk ka staf te kualifikuar qe ka mbi 5 vjet përvojë pune (mund te këtë staf te tille qe kanë kryer jashtë vendit para vitit 2015, mirëpo e kemi konsideruara që janë të rrallë).

Po ashtu ju njoftojmë se nuk është kërkuar i gjithë stafi të jetë pjesë e listës së ATK-ës për tri vitet e fundit, përjashtim këtu është stafi shtesë i cili është më specifik, bëhet fjalë për ekspertin e licencuar me VMN dhe inxhinierin e trafikut.

Pretendimi 2

Personeli shtese per kete projekt

nje master i biologjise (ose to ngjashem), i licencuar per VNM (Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis) nga MMPI-I (nga viti kaluar i lajmeruar ne ATK te ofertuesi) inxhinier i diplomuar ose master i trafikut rrugor (komunikacionit) — i certifikuar per projektim te udhekryqeve me sinjale ndricuese, i certifikuar per auditim te sigurise rrugore sipas direktives evropiane 2008 96 EC. Pervoja e punes ti pergjigjet pozicionit 16 dhe 17 te paramases. Pervoja e kerkuar se paku 5 vite (me kontrate origjinal te bashkangjitur edhe leternjoftimin ose kontrate te noterizuar)

Eshte per to habitur qe edhe te personeli shtese u desh nje specifikim i till! Se pail nje master i biologjis (ose te ngjashem) i licencuar per VMN, por jo tre vitet e fundit ne ATK por nga viti i kaluar! Kjo nuk eshte asgje me shume as me pak se sa pershtatje per Operator Ekonomik te caktuar dhe diskriminim te OE te tjere. Kerkesa e till ne FDT ngushton edhe me shume mundesin konkuruese pa ndikuar ne marrjen e sherbimeve cilesore!

Ndersa, kerkesa e specifikuar inxhinier i diplomuar ose master i trafikut rrugor (komunikacionit), nuk mjafton per AK por duhet edhe certifikim per projektim te udhekryqeve me sinjale ndricuese! Nuk mjafton me Iraq por duhet te jete dhe i certifikuar per auditim te siguris rrugore! **Vlen te theksohet ky lloj certifikimi i kerkuar akoma nuk behet ne Republiken e Kosoves.** Kjo nuk eshte asgje me shume as me pak se sa pershtatje per Operator Ekonomik te caktuar dhe diskriminim e OE te tjere. Kerkesa e till ne FDT, ngushton edhe me shume mundesin konkuruese pa ndikuar ne marrjen e sherbimeve cilesore! Vlen te theksohet se ky ekspert mund te jete me kontrate dhe leternjoftim (sepse kete ekspert OE i favorizuar me keto kushte nuk e ka ne listen e ATK-se as per nje vit sic e ka ekspertin me VMN), kjo eshte aq e thjesht per ta kuptuar!

Përgjigje 2: Sa i përket pretendimit tuaj për ekspertin e licencuar me VNM, ju njoftoj se ai/ajo mund të paraqitet si staf shtesë i kontraktuar për këtë projekt. Pra nuk ka nevojë që të jetë detyruesisht pjesë e listës së ATK-ës (pretendimi i juaj është i bazuar dhe e konsiderojmë si lëshim nga ana jonë, një sqarim i tillë i është dhënë një tjetër operatori që ka kërkuar sqarime). Sa i përket pretendimit tuaj për inxhinierin e diplomuar ose master i trafikut rrugor (komunikacionit), ju njoftoj se Inxhinieri i trafikut rrugorë i cili është kërkuar, përveç shkollimit të nivelit master dhe përvojës së paku 5 vjeçare duhet të jetë i licencuar edhe si auditor i sigurisë rrugore, kjo për faktin se në pikën 17 të paramases kërkohet “Auditimi i sigurisë rrugore te rrugëve dhe objekteve në rrugë”, një shërbim të tillë mund ta kryen vetëm auditori i licencuar për siguri rrugore. AK ka në planë që duke u mbështetur në direktiven evropiane 2008 96 EC, të kryen auditimin e sigurisë rrugore për rrugët komunale, një raport i tillë na shërben për krijimin e një strategjie për ngritjen e nivelit të sigurisë rrugore. Po ashtu ky inxhinier na duhet që të ketë dëshmi (certifikatë) e cila tregon se ka aftësi dhe njohuri të dëshmuar në projektimin e udhëkryqeve me sinjalizim ndriçues (semaforë), AK ka në planë që

të analizoj tërë rrjetin rrugorë dhe udhëkryqet e caktuara duhet të projektohen me sinjalizim me ndriçim (semaforë). Për shkak të keqpërdorimeve të diplomave, licencave kemi kërkuar si dëshmi shtesë kopjen e letërnjoftimit ose kontrata e noterizuar.

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, 9.1 & 9.2

Operatori Ekonomik duhet të ketë të paktën një instrument GPS për matje gjeodezike-Instrument! duhet të jetë i kalibruar dhe në gjendje të rregullt teknike.

Pretendimi 3. Kërkesa për pajisjet gjeodezike mend të mbulohet nga një kompani projektuese nga një nënkontraktor që merret specifikisht me punë gjeodezike e ka bashkëpunim sa i përket shërbimeve gjeodezike.

Prandaj, kërkesa sa i përket këtyre pajisjeve duhet të modifikohet sepse mend të plotësohet me një nënkontraktor.

Përgjigje 3: Sa i përket pretendimit tuaj për instrumentin GPS për matje gjeodezike, ju njoftoj se mund të kontraktohet një kompani (operatorë) që ofron një shërbim të tillë dhe i cili ka të paktën një instrument të kalibruar dhe në gjendje të rregullt teknike ashtu siç është kërkuar në FDT.

Operatori Ekonomik duhet të ketë zyrë në zonën urbane të qytetit të Gjakovës.

Pretendimi 4: Sa i përket kërkesës së AK, që OE detyrimisht të ketë zyrë në zonën urbane të Gjakovës sa është e pakuptimtë, tendencioze dhe shumë e turpshme. Kur bota sot dhe teknologjia e komunikimit ka arritur nivelet me të larta që ka njohur njerzimi deli sot Komuna e Gjakovës detyron një ndërmarrje Projektuese profesionale të ketë zyrë dhe atë vetëm në zonën Urbane të qytetit! Nëse duhen takime fizike e gjithë Kosova, maksimumin e arritjes prej cilit do vend të Kosovës në Gjakovë e ka një orë e tridhjet minuta. Cili është qëllimi i kësaj kërkesë të AK!?

Përgjigje 4: Për shkak të volumit të punës që kërkohet të kryhet nga projektuesit dhe për shkak të kontrollit sistematik (nga komisioni i kontratës) të fazave projektuese, na duhet që operatori të ketë zyrë brenda zonës urbane në mënyrë që të shërbejë si kabinet pune për projektuesit dhe komisionin e pranimit.

Ju njoftojmë se kontrata për qira marrje për zyrën në fjalë, është e pranueshme edhe nëse lidhet me kusht që të filloni shfrytëzimin e zyrës pas nënshkrimit të kontratës me AK.

Për shkak të ngritjes së shqetësimit për këtë pikë që kemi pranuar deri më tash nga katër operatorë dhe duke u mbështetur në kufizimin e lëvizjes për shkak të gjendjes së pandemisë, në mënyrë që operatorët (të cilët kanë selinë jashtë Komunës së Gjakovës) mos të obligohen që të lëvizin për të lidhur kontrata me poseduesit e zyrës në zonën urbane të Gjakovës, Njësia e kërkesës i ka rekomanduar zyrës së prokurimit që kjo pikë të ndryshohet duke shtuar se vlen vetëm për operatorin fitues të këtij aktiviteti.

Përgjigje 5: Sa i përket pretendimit tuaj për termin Ri-projektim, ju njoftojmë se ky pozicion nënkupton ri-projektimin e projekteve ekzistuese që AK posedon, pra në rastet kur kërkohet që projektet ekzistuese të ndryshohen, shfrytëzohen këto pozicione, ju duhet të ofertoni për ri-projektimin e projekteve që AK ka në disponueshmëri (të deponuara).

Dallimi në mes të rrugëve me dy, tre apo katër shirita të qarkullimit për zonën urbane dhe rurale dallon në thelb sa i përket kompleksitet të punës apo projektimit, p.sh. një rrugë në zonën urbane kërkon punë më të madhe për projektim për shkak të problemeve pronësore, analizës së qarkullimit, trajtimi i objekteve, përmbajtjes së planeve rregulluese urbane etj. Ndërsa në zonën rurale projektimi është më pak kompleks. E njëjta përgjigje vlen edhe për kanalizimet edhe ujësjellësin, prandaj është ndarë në dy zona.

Sa i përket dallimit në mes të projektimit të urave me gjatësi deri në 10 m dhe mbi 10 m, dallimi është tek volumi i punës gjatë projektimit, ura deri në 10 m ka volum më të vogël të punës në projektim se sa ura mbi 10 m.

Sa i përket pozicionit 13 dhe 16, ju njoftojmë se pozicioni 13 ka për qëllim që të projektohen udhëkryqet e të gjitha llojeve me përjashtim të udhëkryqit me sinjalizim ndriçues, sa i përket pretendimit tuaj për njësi matëse konsiderojmë se është i bazuar dhe është një lëshim nga ana jonë njësi matëse për këtë pozicione duhet të jetë copë, e jo m'.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Arkivitet të Komunës

z.Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

